



Instituti Gjyqësor i Kosovës
Kosovski Institut za Pravosudje
Kosovo Judicial Institute

PROGRAMI I PUNËS 2017

PROGRAMI
I PUNĒS
2017



Instituti Gjyqësor i Kosovës

© IGJK 2016, Të gjitha të drejtat e rezervuara
Përmbajtja e këtij materiali nuk mund të rishtypet,
shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo formatjetër
elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose
regjistrohet pa miratimin me shkrim të Institutit
Gjyqësor të Kosovës (IGJK).

**Programi i Punës është miratuar
nga Këshilli Drejtues i IGJK-së me datën 06.12.2016**

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Hyrje	7
1.1 Misioni dhe Vizioni.....	9
1.2 Kompetencat e IGJK-së sipas ligjit.....	9
1.3 Objektivat strategjike	10
2. Programi i Trajnimeve për vitin 2017	11
2.1 Qëllimi.....	13
2.2 Objektivat e programit	14
2.3 Prioritetet trajnuese	15
2.4 Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV).....	15
2.5 Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)	16
2.6 Trajnimet për Avancim (TA)	16
2.7 Programi për Hulumtime dhe Publikime (PHP).....	16
2.8 Administrimi i gjykatave dhe prokurorive.....	17
2.9 Kurse trajnuese për profesionistët tjerë	17
2.10 Trajnimi për Trajnues (ToT).....	18
2.11 Mësimi në distancë.....	18
3. Administrata, financat dhe infrastruktura e IGJK-së.....	19
3.1 Objektivat e administratës dhe financave	20
3.2 Burimet njerëzore	20
3.3 Burimet financiare	21
3.4 Prokurimi	21
3.5 Shërbimet tjera administrative.....	21
4. Programet e përbashkëta me partner strategjik.....	22
5. Plani për zbatim të programit të punës së IGJK-së.....	25
6. SFIDAT DHE RREZIQET	32
7. Përfundimi.....	34

1. HYRJE

Bazuar në Ligjin për Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës (Ligji nr. 02/L-25), IGJK është i mandatuar si organ i pavarur dhe institucion kryesor i trajnimit gjyqësor në Kosovë, i cili është kompetent për hartimin dhe realizimin e programeve trajnuese për gjyqtarë, prokurorë dhe profesionist tjerë brenda sistemit gjyqësor e prokurorial. Po ashtu IGJK kryen veprimtari të tjera profesionale si institucion profesional-kërkimor për zhvillimin e gjyqësisë në Kosovë në pajtim me standardet evropiane.

Programi i punës së IGJK-së për vitin 2017, përmban aktivitetet që IGJK planifikon t'i realizoj në mbështetje të ngritjes së kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve, dhe profesionistëve tjerë në kuadër të sistemit gjyqësor e prokurorial, si dhe prioritetet e IGJK-së, me qëllim të zhvillimit të një sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm dhe efikas.

Programi i punës për vitin 2017, përfshinë trajnimet e vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë, të cilat përmbajnë tema dhe module të karakterit tërësisht profesional, dhe karakterit interdisiplinar, trajnime për trajnues, programe orientuese për gjyqtarët dhe prokurorët e avancuar, trajnime fillestare për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar, trajnime për menaxhmentin dhe stafin mbështetës të gjykatave dhe prokurorive.

Pjesë e këtij programi janë edhe trajnimet nga distanca, aktivitetet që do të zhvillohen në drejtim të ofrimit të mundësive për qasje në burime ligjore, hulumtime dhe publikime, si dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit, prokurimit, tekonojgjisë informative, burimeve njerëzore dhe shërbimeve tjera të përgjithshme, si një komponent mjaftë e rëndësishme e IGJK-së përveç trajnimeve, të cilat ofrojnë mbështetje në zbatimin e këtij programi.

IGJK do të vazhdojë bashkëpunimin me donatorët dhe partnerët ndërkombëtar në mbështetje të realizimit të aktiviteteve të ndryshme nga ky program. Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtarë, do të realizohen aktivitete përmes pjesëmarrjes në konferenca dhe aktivitete tjera të ndryshme regjionale dhe ndërkombëtare që kanë në fokus ngritjen e kapaciteteve profesionale për gjyqtarët dhe prokurorët vendor shkëmbimin e praktikave më të mira në fushën e trajnimit gjyqësor si dhe anëtarësimin në mekanizma të ndryshëm rajonal në funksion të zbatimit të mandatit të IGJK-së.

Gjatë përgatitjes së këtij programi trajnues janë marrë në konsideratë edhe zhvillimet rreth procesit të transformimit të IGJK-së në Akademi të Drejtësisë.



1.1 Misioni dhe Vizioni

Instituti Gjyqësor i Kosovës fokusohet në zhvillimin dhe ofrimin e programeve bashkëkohore trajnuese, në ngritje të kapaciteteve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, për zbatim të standardeve më të larta të performancës profesionale dhe etike, gjatë ushtrimit të funksioneve gjyqësore nga bartësit e këtyre funksioneve.

Misioni i IGJK-së është që të mbështesë ngritjen e vazhdueshme profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përfshirë edhe ata të sapoemëruar, të stafit të gjykatave dhe prokurorive si dhe të zhvillojë plane aftësimi dhe veprimtari profesionale kërkimore në drejtim të ofrimit të trajnimeve cilësore dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare.

Vizioni i IGJK është, që në koherencë me dinamikën e zhvillimeve të gjithanshme, të avancohet më tej si një institucion profesional në ofrimin e programeve trajnuese dhe formave tjera të mbështetjes për sistemin gjyqësor dhe prokurorial profesional të pavarur dhe të paanshëm.

1.2 Kompetencat e IGJK-së sipas ligjit

IGJK bazuar në kompetencat ligjore, është institucion përgjegjës për:

- Aftësimin e bartësve dhe bartësve potencial të funksionit në gjyqësi (gjyqtarëve dhe prokurorëve);
- Vlerësimin dhe organizimin e provimit përgatitor për gjyqtarë dhe prokurorë¹;
- Kurset e posaçme të aftësimit për avancim të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Kurse për aftësimin bazë të gjyqtarëve porotë; dhe
- Kurse për aftësimin e profesionistëve të tjerë në lëmin e gjyqësisë të identifikuar nga IGJK-ja.

IGJK-ja gjatë punës së vet, po ashtu kryen edhe funksione tjera si më poshtë:

- Zhvillon plane aftësimi afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për një gjyqësi efikase, efektive dhe të paanshme;
- Kryen edhe veprimtari të tjera profesionale si institucion profesional-kërkimor për zhvillimin e gjyqësisë në Kosovë në pajtim me standardet evropiane.

¹ Me ndryshimet e fundit ligjore organizimi i provimit përgatitor është kompetencë e KGJK dhe KPK, megjithatë Ligji për Themelimin e IGJK-së nuk ka ndryshuar ende

1.3 Objektivat strategjike

Hartimi i një plani strategjik afatmesëm apo afatgjatë mund të mos jetë i zbatueshëm, real dhe nuk do të mund të përmbushë pritjet dhe objektivat e përcaktuara, për shkak të procesit aktual të reformës së arsimimit ligjor në Republikën e Kosovës që njëkohësisht prek edhe mandatin ligjor të IGJK-së.

Për këtë arsye IGJK konsideron se hartimi i objektivave strategjike për vitin 2017 është më se i nevojshëm dhe mundëson zbatimin e aktiviteteve përmes planeve konkrete të veprimit që do të kryhen gjatë vitit 2017, duke përcaktuar në të njëjtën kohë departamentet përgjegjëse për realizimin e tyre dhe kohën se kur do të realizohen.

Si objektiva strategjike për 2017, IGJK përcakton:

- Realizimi i procesit të transformimit i cili garanton vijueshmërinë e zbatimit të programit trajnues²,
- Hartimi dhe zbatimi i programeve adekuate trajnuese,
- Transparenca dhe gjithë përfshirja,
- Zhvillimi i hulumtimeve dhe publikimeve,
- Ofrimi i resurseve dhe burimeve ligjore për përfituesit e IGJK-së,
- Zbatimi i standardeve për menaxhimin financiar dhe sistemin e kontrollit,
- Zhvillimi i akteve normative dhe dokumenteve të punës (hartimin e akteve normative të brendshme të IGJK-së, hartimin e planit të punës),
- Zhvillimi i kapaciteteve administrative dhe resurseve njerëzore,
- Koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstytucional,
- Programet praktike brenda dhe jashtë vendit,

IGJK do të zhvilloj plane veprimi për zbatimin e objektivave strategjike për vitin 2017.

² Zbatimi i këtij objektivi varet nga zhvillimet rreth miratimit të projektligjit për Akademinë e Drejtësisë

2. PROGRAMI I
TRAJNIMEVE
PËR VITIN
2017

Programi i Trajnimeve për vitin 2017 mbulon fushat kryesore të punës së gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë në kuadër të sistemit gjyqësor, i cili do të jetë bazë për hartimin e kurrikulave dhe organizimin e trajnimeve për këtë periudhë.

Ky program rezulton nga procesi gjithëpërfshirës i vlerësimit të nevojave të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë në kuadër të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë. Prosesi ka përfshirë rekomandimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndryshimet legislative, strategjitë e zbatueshme që prekin fushën e gjyqësorit, raportet dhe rekomandimet e ndryshme të organizatave dhe institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, si dhe dokumente tjera strategjike për zhvillimin e sistemit gjyqësor të pavarur, të paanshëm, efektiv dhe efikas.

Struktura e trajnimeve për vitin 2017 do të jetë si më poshtë:

- Kompetencat profesionale
- Kompetencat interdisiplinare
- Kompetencat personale

Komponentët kryesore të Programit të Trajnimeve janë:

- Trajnimet e Vazhdueshme
- Trajnimet Fillestare
- Trajnimet për Avancim
- Hulumtimet dhe Publikimet
- Trajnimet për Trajnues
- Trajnime për administrimin e gjykatave dhe prokurorive
- Trajnimet për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive si dhe profesionistëve tjerë nga fusha e gjyqësisë të identifikuar nga IGJK
- Trajnimet nga distanca

Varësisht dinamikës së zhvillimeve të reja, programi i punës dhe programet e trajnimeve do të rishikohen dhe plotësohen duke ju përshtatur këtyre zhvillimeve dhe nevojave të përfituesve të trajnimeve.

2.1 Qëllimi

Programi i Trajnimeve ka për qëllim të përcaktoj fushat dhe temat, të cilat IGJK bashkërisht me përfituesit dhe partnerët tjerë i ka vlerësuar të rëndësishme të përfshihen në programin trajnues për vitin 2017 të cilat reflektojnë nevojat reale dhe kërkesat për trajnime.

Qëllimet kryesore, por jo të vetmet, të programit trajnues janë;

- Gjithëpërfshirja në trajnime e gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë;
- Adresimi i plotë dhe i saktë i nevojave të përfituesve për trajnime;
- Përditësimi i programit trajnues duke e përshtatur me zhvillimet legjislative;
- Koordinimi i pjesëmarrjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajnime;
- Ofrimi i trajnimeve adekuate për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar dhe atyre që avancohen apo ndryshojnë pozitat e tyre;
- Bashkëpunimi me donator për implementim të aktiviteteve të përbashkëta
- Planifikimi dhe shpenzimi i buxhetit;

Hartimi i këtij programi ndihmon të gjitha strukturat e IGJK-së, përfshirë edhe trajnuesit për përgatitjen në kohë reale, meqë programi përcakton fushat e përfshira në Programin e trajnimeve për periudhën 1 vjeçare.



2.2 Objektivat e programit

Objektivat që synon të arrij Programi i trajnimit për vitin 2017 janë:

- Ngritja e kapaciteteve profesionale e gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë;
- Zbatimi i trajnimeve interdisiplinare për gjyqtarë dhe prokurorë;
- Zhvillimi i shkathtësive të posaçme për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar apo që janë avancuar;
- Ofrimi i trajnimeve në përputhje me nevojat e stafit të gjykatave dhe prokurorive;
- Zhvillimi i fushës hulumtuese kërkimore dhe botimi i publikimeve;
- Zbatimi i kurseve trajnuese në platformen e mësimit në distance (e-learning);
- Ofrimi i resurseve dhe burimeve juridike përmes bibliotekës së IGJK-së;
- Zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët vendor dhe ndërkombëtarë;
- Avancimin e metodologjisë moderne gjatë zbatimit të programeve trajnuese;
- Pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme për trajnim gjyqësor me karakter ndërkombëtarë;

2.3 Prioritetet trajnuese

Qëllimet kryesore të Programit të Trajnimeve, konsistojnë në përmbushjen e nevojave reale të përfituesve për trajnime duke marr parasysh dhe kapacitetet e IGJK-së, veçanërisht ato buxhetore sipas të cilave përcaktohen fushat me prioritet gjatë zbatimit të trajnimeve.

Bazuar në këtë, IGJK vlerëson se fushat me prioritet më të lartë gjatë hartimit dhe zbatimit të trajnimeve, nga fusha penale do të jenë; krimi i organizuar, pastrimi i parave, korrupsioni, trafikimi me njerëz, terrorizmi, trafikimi me substanca narkotike, krimi kibernetikë, dhe institute të ndryshme nga Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale me interes gjykatat dhe prokuroritë, përfshirë edhe profesionistë tjerë.

Me prioritet do të jenë edhe trajnimet nga lëmia civile si në aspektin material ashtu edhe atë procedural si; kontratat e ndryshme, çështjet familjare, çështjet pronësore, drejtësia për fëmijë në aspektin civil, dhuna në familje etj.

Programi i trajnimeve, po ashtu do të trajtoj edhe çështjet nga e drejta tregtare, konkurrenca, prona intelektuale, mbrojtja e konsumatorit, të drejtat e njeriut, e drejta e BE-së, fusha administrative, mbrojtja e ambientit, menaxhimi dhe administrimi i gjykatave dhe prokurorive, etika profesionale, si dhe çështjet tjera të cilat përcaktohen si raste me prioritet për gjykatat dhe prokuroritë e shtetit.

Komponent e rëndësishme e këtij programi do të jenë edhe çështjet si; organizimi i tryezave, konferencave dhe seminareve me karakter studimor, zbatimi i programeve të ndryshme të praktikës në institucionet gjyqësore e prokuroriale në vendet e regjionit si dhe ato ndërkombëtare.

2.4 Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)

Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV) i dedikohet gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë. Varësisht prej temës, në trajnime të PTV-së marrin pjesë edhe profesionist tjerë, funksioni dhe detyrat e punës të të cilëve lidhen me punën e gjykatave dhe prokurorive. PTV për vitin 2017 reflekton nevojat e gjyqtarëve dhe prokurorëve për zbatim të strukturës ligjore në fuqi, përfshirë edhe risitë legjislative, si dhe strategjitë e ndryshme të vendit në fushën e gjyqësorit që kanë të bëjnë veçanërisht me procesin e integriteteve.



2.5 Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)

Programi i trajnimit fillestar iu është dedikuar gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar.

Ky program është i strukturuar në dy pjesë: pjesën teorike dhe atë praktike. Pjesa teorike e këtij programi mbulon të gjitha degët e së drejtës dhe ligjet pozitive vendore po ashtu edhe ato të Acquis communautaire, Konventen Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe aktet tjera ndërkombëtare. Pjesa praktike e trajnimit zhvillohet në gjykata apo prokurori, varësisht prej pozitës, ku gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar ndjekin trajnimin praktik, nën mbështetje të mentorit i cili është gjyqtar apo prokuror.

Realizimi i Programit për Trajnim Fillestar bëhet bazuar në strukturën e moduleve trajnuese të përcaktuara nga Këshilli Drejtues i IGJK-së i cili hartohet në bashkëpunim me KGJK dhe KPK të cilat janë përgjegjëse për organizimin e provimit për gjyqtarë përkatësisht prokurorë si parakusht për fillimin e trajnimit.

2.6 Trajnimet për Avancim (TA)

Trajnimet për Avancim (TA) i'u dedikohen gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët janë avancuar apo kanë ndërruar nivelet dhe funksionet brenda gjykatave dhe prokurorive.

Qëllimi i TA-së është, që përmes ofrimit të programeve orientuese, tu ofrohet mbështetja e gjyqtarëve dhe prokurorëve në ngritjen dhe aftësimin e tyre profesional përkritazi me përgjegjësitë e reja të funksionit dhe nivelit në të cilin kanë kaluar.

Programi konsiderohet si pjesë i PTV-së, përmes të cilit ofrohen trajnime specifike në mbështetje të këtyre kategorive përfutuese, duke i'u përshtatur nevojave të departamenteve të nivelit dhe funksionit aktual të tyre.

2.7 Programi për Hulumtime dhe Publikime (PHP)

Programi për Hulumtime dhe Publikime (PHP), i'u dedikohet gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë në gjyqësi. Ky program synon që të ofroj resurse ligjore të nevojshme, mbështetje praktike për hulumtim, si dhe publikimin e rezultateve të hulumtimeve për çështje të ndryshme ligjore që i hasin gjatë punës praktike. Po ashtu ky program ofron edhe analiza dhe hulumtime të ndryshme në mbështetje të zhvillimit dhe përmirësimit të programeve trajnuese të IGJK-së.

2.7.1 Bibloteka e IGJK-së

Bibloteka ligjore shërben si një burim kryesor i materialit hulumtues ligjor, e cila vepron sipas standardeve bashkëkohore të bibliotekave ligjore, përmes platformave elektronike si dhe databazave të abonuara. IGJK aktualisht ka funksionale bibliotekën fizike dhe atë elektronike, të cilat janë të pasura me literaturë nga fusha juridike, të nivelit vendor dhe ndërkombëtarë.

2.8 Administrimi i gjykatave dhe prokurorive

Administrimi efikas i gjykatave dhe prokurorive është një nga objektivat me prioritet për sistemin gjyqësor dhe prokurorial. Bazuar në këtë është e nevojshme ngritja e performencës për një administrim të drejtë edhe efikas të gjykatave dhe prokurorive. Rol kyç në këtë proces kanë menaxhmenti i gjykatave dhe prokurorive, duke përfshirë kryetarët, gjyqtarët mbikëqyrës të degëve, kryeprokurorët si dhe administratorët e gjykatave dhe prokurorive.

Moduli i trajnimeve për menaxhim do të fokusohet në parimet dhe teknikat për zhvillimin e një administrate moderne, efektive, profesionale dhe transparente nga perspektiva e menaxherëve.

2.9 Kurse trajnuese për profesionistët në gjyqësi

Bazuar në mandatin ligjor, varësisht nevojave, IGJK zhvillon kurse adekuate trajnimi për profesionistët e tjerë, brenda sistemit gjyqësor e prokurorial, siç janë: gjyqtarët porotë, personeli administrativ i gjykatave dhe prokurorive, stafi i KGJK-së dhe KPK-së si dhe profesionistët tjerë në fushat në të cilat IGJK ka kompetencë dhe mund të ofroj ekspertizë.

Trajnimet për këto kategori do të ofrohen në varësi nga detyrat dhe përgjegjësitë që i ushtrojnë gjatë punës së tyre të rregullt, duke marrë në konsideratë proceset dhe reformat që janë zhvilluar ose janë në proces e të cilat shprehen në mënyrë të drejtpërdrejt nga përfituesit apo si kërkesa të KGJK-së përkatësisht KPK-së.



2.10 Trajnimi për Trajnues (ToT)

Trajnimet për trajnues janë të dedikuara për trajnuesit e IGJK-së, dhe kanë për qëllim të ngrisin shkathhtësitë profesionale rreth teknikave dhe metodologjisë bashkëkohore të zbatimit të trajnimeve. Të gjitha idetë dhe investimet për këtë periudhë programore do të orientohen në dizajnimin dhe zbatimin e trajnimeve të përhershme për trajnues në funksion të përmirësimit të metodologjisë së tyre dhe realizim të trajnimeve atraktive, praktike dhe efektive.

Përvojat e IGJK-së janë përcjellë me zhvillime pozitive në këtë drejtim dhe përveç caktimit të kriterëve për trajnues janë hartuar edhe doracakë për trajnues dhe mentor. Megjithatë mbetet sfida zbatimi i këtyre doracakëve dhe kriterëve të cilat kanë vendosur standarde të avancuara lidhur me metodologjinë trajnuese.

2.11 Mësimi në distancë

Mësimi në distancë (e-learning) nënkupton të mësuarit nga distanca duke shfrytëzuar teknologjinë elektronike online, jashtë një salle tradicionale të trajnimit, të cilat ju ofrohen përfitueseve përmes: kurseve dhe moduleve trajnuese, incizimeve audio dhe videove. Përpjesitë e aplikimit të kësaj forme të të mësuarit janë të shumta, duke kursyer në masë të madhe kohën dhe koston e rrugëtimit, si dhe orarin e përshtatshëm ku pjesëmarrësit në çdo kohë mund të ndjekin një trajnim të caktuar.

Qëllimi i kësaj platforme konsiston në ofrimin e mundësisë, që gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistët tjerë në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, në kohë të përshtatshme dhe të herëpashërme të vijojnë kurset trajnuese, nga distanca me interes për ta. Po ashtu, përmes kurseve trajnuese në këtë platformë, synohet zhvillimi i mëtejshëm profesional për të gjitha kategoritë përfituese të IGJK-së.

IGJK ka funksionalizuar platformën e mësimin në distancë, e cila përmbushë nevojat dhe kërkesat për trajnime sipas kësaj metodologjie të trajnimit.



3. ADMINISTRATA, FINANCAT DHE INFRASTRUKTURA E IGJK-SË

3.2 Burimet njerëzore

Zhvillimi i aktiviteteve të IGJK-së mbështetet nga Departamenti për Administratë dhe Financa përmes administratës, teknologjisë informative, burimeve njerëzore, financave, prokurimit, dhe shërbimeve tjera të përgjithshme.

Zbatimi i programeve të reja trajnuese dhe nevojat për avancime të trajnimeve, ka ndikuar që nevojat dhe kërkesat nga administrata dhe financat të rriten. IGJK duhet të siguroj infrastrukturën fizike, avancimin e teknologjisë informative, fonde të mjaftueshme si dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe administrative të stafit.

3.1 Objektivat e Departamentit për Administratë dhe Financa

Me qëllim të realizimit të aktiviteteve të IGJK-së fokusi kryesor i këtij departamenti do të jetë tek:

- a) avancimi i kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore,
- b) avancimi i sistemit të menaxhimit të financave dhe sistemit të kontrollit,
- c) zhvillimi i prokurimit për realizimin e nevojave të IGJK-së,
- d) zbatimi i teknologjisë informative për nevojat e trajnimeve,
- e) menaxhimi dhe sigurimi i infrastrukturës dhe shërbimeve tjera administrative.

IGJK aktualisht ka 25 pozita të miratuara, që nuk janë të mjaftueshme për të realizuar funksionet në mënyrë efikase, andaj kërkohet rritja e numrit të stafit për realizimin e suksesshëm të aktiviteteve trajnuese të planifikuara nga IGJK. Pozitat e reja kryesisht duhet të jenë profesionale në zbatim të programeve trajnuese dhe pozita administrative të nevojshme për menaxhim dhe administrim të shërbimeve të përgjithshme

Gjithashtu ngritja e kapaciteteve profesionale të burimeve aktuale njerëzore është e nevojshme dhe realizohet përmes trajnimeve të ndryshme, të cilat orientohen varësisht nga niveli funksional i stafit. Në këtë kuadër, IGJK po ashtu do të vazhdoj bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare trajnuese që të siguroj programe të intershipit me qëllim të përfitimit të praktikave më të mira dhe mundësive të reja për zhvillim profesional.



3.3 Burimet financiare

Burim kryesor financiar i IGJK-se është buxheti i Republikës së Kosovës dhe donacionet e ndryshme. IGJK përgatit kërkesën buxhetore në bazë të numrit të aktiviteteve trajnuese të planifikuara dhe ka kapacitete të mjaftueshme për të vlerësuar koston reale për të gjitha aktivitetet e përfshira në buxhetim. Planifikimi buxhetor bëhet përmes shfrytëzimit të mekanizmave të ndryshëm dhe mjaft efikas. Planifikimi i mirë dhe ekzekutimi buxhetor duke respektuar rregullat ligjore në fuqi siguron realizimin e programeve të IGJK-së.

Që nga themelimi, IGJK ka gëzuar mbështetje të vazhdueshme nga partner ndërkombëtarë në mbështetje të realizimit të programeve të veçanta trajnuese. Menaxhimi i donacioneve bëhet mbi bazën e marrëveshjeve të mirëkuptimit dhe planeve konkrete. Fokusi i donacioneve duhet të jetë mbështetja e trajnimeve në përgjithësi dhe në veçanti mbështetja me ekspertizë ndërkombëtare, botime dhe publikime, programe të intershipit dhe vizitat studimore.

Rritja e cilësisë dhe përgjegjësisë në punë behet përmes menaxhimit të mirë dhe kontrollit të vazhdueshëm duke u mbështetur në sistemin e llogaridhënies, hartimit dhe zbatimit të akteve normative të brendshme dhe zhvillimit të auditimit të brend- shëm.

3.4 Prokurimi

Prokurimi është fusha me e ndjeshme dhe për këtë arsye IGJK do të avancoj sistemin e menaxhimit të prokurimit që nga planifikimi e deri te menaxhimi i kontratave duke përfshirë edhe bazën e brendshme elektronike të të dhënave. Legjislacioni në fuqi që e rregullon fushën e prokurimit publik ka pësuar ndryshime, duke bërë centralizimin e prokurimit, që nënkupton zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit dhe lidhjen e kontratave nga ana e AQP-së për IGJK-në. Me këtë ndryshon edhe procesi i realizimit të aktiviteteve të prokurimit. IGJK do të siguroj që planifikimi i prokurimit do të bëhet në harmoni me legjislacionin në fuqi të prokurimit.

3.5 Shërbimet tjera administrative

Në kuadër të shërbimeve tjera të administratës përfshihen të gjitha aktivitetet që mbështesin realizimin e funksioneve të IGJK-së, brenda periudhës vjetore si: teknologjia informative, infrastruktura, furnizimet, transporti, mirëmbajtja, sistemi elektronik i furnizimeve, klasifikimi dhe arkivimi i dokumenteve.

Zbatim i teknologjisë informative në zbatim të programeve trajnuese dhe aktiviteteve tjera përmes sistemit elektronik do të jetë një nder objektivat kryesore në fushën e teknologjisë informative. Mirëmbajtja dhe menaxhimi i pajisjeve harduerike dhe softuerike që posedon IGJK është një proces i vazhdueshëm i cili ofron siguri dhe qëndrueshmëri për këto pajisje. Ndërtesa ku IGJK aktualisht ushtron aktivitetet e tij, përveç që nuk është në pronësi të IGJK-së, nuk ka hapësira të mjaftueshme për zhvillim të aktiviteteve trajnuese dhe gjithashtu zvogëlon buxhetin e IGJK-së duke krijuar shpenzime të qirasë. Përpjekjet e IGJK do të jenë në sigurimin e fondeve për ndërtimin e ndërtesës, parcelën dhe projektin sipas standardeve të institucioneve trajnuese, përmes mbështetjes qoftë vendore apo ndërkombëtare.

4 PROGRAMET E PËRBASHKËTA ME PARTNER STRATEGJIK

Mbështetja e programeve të trajnimeve praktike, programeve të shkëmbimit dhe vizitave studimore jashtë vendit paraqesin një aspekt të veçantë të zhvillimit profesional, ngritjes së shkathtësive menaxhuese dhe vetive ndërpersonale të gjyqtarëve, prokurorëve, dhe profesionistëve të tjerë gjyqësor dhe personelit të IGJK-së. Në këtë aspekt një kontribut të madh janë duke luajtur partnerët dhe donatorët e IGJK-së.

Shkëmbimi i përvojave në ngritje të performancës së tyre mbetet njëri nga synimet kryesore të këtyre programeve me karakter ndërkombëtarë. Ky shkëmbim sot mbetet kërkesë parësore qoftë përmes pjesëmarrjes në iniciativa, forume dhe rrjete me karakter regional e më gjerë, qoftë përmes sjelljes së ekspertizave që mbulojnë fusha me deficit eksperience në vendin tonë.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi IGJK do të vazhdoj të jetë pjesë aktive e angazhimeve në projekte të përbashkëta për zhvillim të gjyqësorit si nga institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, e po ashtu edhe nismave të ndryshme rajonale e më gjerë të cilat kanë mision kryesor zhvillimin e praktikave më të mira për ndërtimin e një sistemi gjyqësor profesional.

Në këtë drejtim gjatë vitit 2017, IGJK do të fokusohet në realizimin e aktiviteteve nga projekti i Binjakëzimit (Twinning) i financuar nga BE, programeve të internshipit, projekteve tjera bilaterale dhe multilaterale ku IGJK është përfitues i drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, programeve tjera trajnuese me donatorë të cilat mund të ofrohen për përfituesit e IGJK-së si dhe pjesëmarrja në takime, trajnime, tryeza pune apo konferenca regjionale dhe ndërkombëtare.



5 PLANI PËR ZBATIM TË PROGRAMIT TË PUNËSSË IGJK-SË

Zbatimi i këtij programi kërkon hartimin e një plani të detajuar në të cilin përcaktohen prioritetet, aktivitetet kryesore, veprimet konkrete, afatet dhe indikatorët kryesor.

Përveç këtij plani të zbatimit për secilin program trajnues veç e veç do të hartohen dokumente të cilat do të jenë pjesë e programeve trajnuese dhe do të shpërndahen tek të gjithë përfituesit e trajnimeve me qëllim që ata të njoftohen me programin dhe t'iu krijohet mundësia e aplikimit për pjesëmarrje.

Programi i punës mund të rishikohet, ndryshohet dhe plotësohet nga Këshilli Drejtues i IGJK-së me kërkesën e Drejtorit, Këshillit Drejtues apo Këshillit Programor, në rast të zhvillimeve të reja në sistemin gjyqësor e prokurorial apo kërkesa që dalin si pasojë e ndryshimeve të mëdha legislative të cilat mund të kenë efekt në zbatimin e këtij programi.

Prioriteti	Aktiviteti	Departament i/ programi	Veprimi	Afati kohor	Indikator/Rezultati
1. Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm	Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme	PTV	Përcaktimi i përfituesve Përcaktimi i kalendarit Caktimi i trajnuesve Hartimi i agjendave dhe materialeve tjera trajnuese	Janar dhjetor	Raportet e trajnimeve Agjendat Listat e aplikuesve Listat e pjesëmarrësve
	Rishikimi dhe plotësimi i listave të trajnuesve	DP	Propozimi i listës Takimet e komisionit	Janar dhjetor	Listat e rishikuara
	Avancimi i sistemit të vlerësimit të trajnimeve	PTV	Ri-hartimi i formularëve	Janar korrik	Formularët e hartuar
	Zbatimi i mekanizmave për vlerësim të nevojave dhe përpunimi i të dhënave	PTV	Zhvillimi i pyetësorëve Takimet me gjyqtarë dhe prokurorë	Qershor tetor	Përmbledhje e nevojave për trajnim
	Rifreskimi i kurrikulës trajnuese	PTV	Takime dhe tryeza me përfitues Programet me donator	Janar dhjetor	Aktivitetet ad hoc të realizuara
	Hartimi i draft programit të trajnimeve për vitin 2018	PTV	Tryeza, punëtori dhe takime me ekspertë	Shtator nëntor	Drafti i hartuar

Prioriteti	Aktiviteti	Departamenti / programi	Veprimi	Afati kohor	Indikator/Rezultati
2. Trajnimi fillestar	Hartimi i draft programit për gjyqtarët e sapoemëruar	PTF	Tryezë, punëtori për hartimin e moduleve	janar shkurt	Drafti i hartuar
	Organizimi i trajnimeve për prokurorët e sapoemëruar	PTF	Përcaktimi i kalendarit Caktimi i trajnuesve Hartimi i agjendave dhe materialeve tjera	Varet nga procesi i dekretimit	Raportet e trajnimeve Agjendat Listat e pjesëmarrësve
	Organizimi i trajnimeve për gjyqtarët e sapoemëruar		Përcaktimi i kalendarit Caktimi i trajnuesve Hartimi i agjendave dhe materialeve tjera	Varet nga procesi i dekretimit	Raportet e trajnimeve Agjendat Listat e pjesëmarrësve
3. Hulumtimet dhe publikimet	Publikimet	PHP	Publikimi i revistave dhe dokumenteve tjera të IGJK-së	Janar dhjetor	Opinio juris e publikuar Justicia e publikuar Modulet trajnuese të publikuara Raporti vjetor 2016 i publikuar Programi trajnues për vitin 2018 i publikuar Programi i punës për vitin 2018 i publikuar
	Identifikimi i nevojave për hulumtime dhe publikime gjyqësore	PHP	Zhvillimi i pyetësorëve Takimet me gjyqtarë dhe prokurorë	Mars prill	Raporti
	Rritja e numrit të koleksioneve të bibliotekës së IGJK-së	PHP	- Hulumtimi për titujt të ri në fushën juridike - Hulumtimi për databaza ligjore	Janar dhjetor	Raporti me numrin e titujve të blerë Abonimi në data bazat ligjore përmes ABEK dhe data bazave tjera Katalogu i titujve të bibliotekës
	Buletini	PHP	Përmbledhja e aktiviteteve të realizuara	janar dhjetor	Buletinet e publikuar

Prioriteti	Aktiviteti	Departamenti/ programi	Veprimi	Afati kohor	Indikator/Rezultati
4. Organizimi i trajnimeve për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive	Organizimi i trajnimeve	DP	Përcaktimi i përfituesve Përcaktimi i kalendarit Caktimi i trajnuesve Hartimi i materialeve trajnuese	Prill dhjetor	Raportet e trajnimeve Agjendat Listat e aplikuesve Listat e pjesëmarrësve
	Vlerësimi i nevojave	DP	Zhvillimi i pyetësorëve Takimet me KGJK, KPK dhe përfituesit	Qershor tetor	Drafti i parë i programit bazuar në procesin e vlerësimit të nevojave
	Hartimi i kurrikulës së trajnimeve		Përpunimi dhe vlerësimi i të gjeturave Tryeza, punëtori dhe takime me ekspertë	Shtator nëntor	Drafti i hartuar
5. Organizimi i trajnimeve për menaxhmentin e administratës dhe stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive	Organizimi i trajnimeve	DP	Përcaktimi i përfituesve Përcaktimi i kalendarit Caktimi i trajnuesve Hartimi i materialeve trajnuese	janar dhjetor	Raportet e trajnimeve Agjendat Listat e aplikuesve Listat e pjesëmarrësve
	Vlerësimi i nevojave	DP	Zhvillimi i pyetësorëve Takimet me KGJK, KPK dhe përfituesit	Qershor tetor	Drafti i parë i programit bazuar në procesin e vlerësimit të nevojave
	Hartimi i draftit të programit	DP	Tryeza, punëtori dhe takime me ekspertë	Shkurt mars	Drafti i hartuar
6. Trajnimi për Trajnues	Organizimi i trajnimeve për trajnues	DP	Identifikimi i pjesëmarrësve Përcaktimi i kalendarit	Prill dhjetor	Raportet e trajnimeve Agjendat Listat e pjesëmarrësve
	Vlerësimi i nevojave	DP	Zhvillimi i pyetësorëve Takimet me përfituesit Përpunimi dhe vlerësimi i të gjeturave	Qershor tetor	Drafti i parë i programit bazuar në procesin e vlerësimit të nevojave
	Hartimi i kurrikules së trajnimeve për trajnues	DP	Vlerësimi i performancës së trajnuesve Tryeza pune, takime dhe konsultime me ekspert Shkëmbim i përvojave me institucionet tjera trajnuese	shkurt mars	Kurrikula e hartuar
7. Trajnimet nga distanca	Realizimi i trajnimeve në e-learning	DP	Përcaktimi i përfituesve Përcaktimi i kalendarit Caktimi i trajnuesve Hartimi i materialeve trajnuese	janar dhjetor	Raportet e trajnimeve Agjendat Listat e pjesëmarrësve
	Përcaktimi dhe hartimi i moduleve	DP	Tryeza pune me ekspertët dhe stafin e IGJK	Janar dhjetor	Modulet e hartuara
8. Planifikimi strategjik i IGJK-së	Hartimi i planit strategjik	IGJK	Tryeza pune, Punëtori	Mars qershor	Plani strategjik i hartuar
	Hartimi i programit të punës 2017	IGJK	Tryeza pune, Punëtori, Takime me ekspert	Tetor Nëntor	Plani i punës i hartuar

Prioriteti	Aktiviteti	Departamenti/ programi	Veprimi	Afati kohor	Indikator/Rezultati
9. Bashkëpunimi dhe partneriteti	Zbatimi i memorandumeve të bashkëpunimit	IGJK	Takime dhe kontakte të rregullta me institucionet partnere	Janar dhjetor	Raportet
	Zbatimi i projektit të binjakëzimit	IGJK	Koordinimi adekuat me këtë program binjakëzimi	Janar dhjetor	Raportet
	Koordinimi me donatorë	IGJK	Takime të rregullta	Janar dhjetor	Raportet Takimi Koordinues me donatorë
10. Takimet e Këshillit Drejtues	Mbledhje të rregullta	IGJK	Takime, tryeza pune	Shkurt, Prill, Qershor, Shtator, Nëntor Dhjetor,	Agjenda Procesverbali Vendimet Aktet normative të miratuara Miratimi i Raportit vjetor 2016 Miratimi i Programit të Punës 2018
11. Aktet normative	Rishikimi i akteve ligjore ekzistuese	IGJK	Vlerësimi dhe efekti i ndryshimeve të reja ligjore Rishikimi i akteve	Janar Dhjetor	Aktet e ndryshuara
	Udhëzimi për klasifikim të dokumenteve	DAF	Hartimi i udhëzimit	Janar - mars	Udhëzimi hartuar
	Rregullorja për arkiv	DAF	Hartimi i rregullores	Janar - mars	Rregullorja e hartuar
	Aktet tjera nënligjore krahas zhvillimeve	IGJK	Hartimi i rregullores		Rregullorja e hartuar

Prioriteti	Aktiviteti	Departamenti/ programi	Veprimi	Afati kohor	Indikatori/Rezultati
12. Menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit	Vlerësimi dhe planifikimi buxhetor 2018-2020	DAF	Vlerësimi i nevojave Përgatitja e KASH-it 2018-2020 Përgatitja e buxhetit 2018 dhe vlerësimet 2019-2020 Regjistrimi në BDMS dhe PIP sistem	Janar shtator	KASH-i dhe buxheti i hartuar
	Zbatimi i buxhetit sipas planifikimit	DAF	Përgatitja e Rrjedhës së Parasë Përgatitja e planit detaj të zotimit dhe shpenzimeve Regjistrimi i shpenzimeve në bazën e të dhënave dhe SIMFK Përgatitja e raporteve financiare	Janar dhjetor	Zbatimi i buxhetit sipas planifikimit
	Kontrulli financiar dhe menaxhimi i rrezikut	DAF	Përgatitja e formularëve për vetëvlerësim Auditimi Përgatitja dhe zbatimi i planit për zbatim të rekomandimeve të ZAP Përgatitja e manualit të pagesave Hartimi i regjistrimit të rreziqeve 2017	Janar Dhjetor	Marrëveshjet e bashkëpunimit Raportet e auditimit Manuali i përgatitur Regjistri i rreziqeve i hartuar
13. Ngritja e shkathësive profesionale te resurseve njerëzore	Planifikimi i personelit duke përfshirë edhe pozitave të reja të nevojshme	DAF	Rishikimi i detyrave të punës Përshkrimi i detyrave për pozitave të nevojshme Kërkesat për rritje të stafit Plotësimi i pozitave të lira	Janar Mars	Plani i personelit
	Trajnime dhe programe ineshipi për staf	DAF	Vlerësimi i nevojave Përgatitja e programit	Janar Dhjetor	Raportet e trajnimeve
	Vlerësimi i performances së punës	IGJK	Planet e punës Takimet Përgatitja e formularëve	Dhjetor	Formularët e vlerësimit
14. Zhvillimi i prokurimit sipas nevojave të programeve	Planifikimi dhe zbatimi i prokurimit sipas nevojave dhe procedurave ligjore	DAF	Identifikimi i nevojave Përgatitja e planit vjetor Përgatitja e raporteve të prokurimit Regjistrimi në bazën e të dhënave	Janar Dhjetor	Plani i përgatitur
	Krijimi i një sistemi të rregullt në lidhje me specifikacionet teknike dhe menaxhimit të kontratave	DAF	Përcaktimi i rregullave të brendshme të prokurimit Përcaktimi i specifikacioneve Rregullat për menaxhim të kontratave	Janar Dhjetor	Rregullat dhe listat e përgatitura

Prioriteti	Aktiviteti	Departament i/ programi	Veprimi	Afati kohor	Indikatori/Rezultati
15. Sërbimet e përgjithshme	Avancimi dhe zbatimi i teknologjisë informative në realizimin e programeve trajnuese	DAF	Mirëmbajtja e pajisjeve harduerike dhe softuerike Azurnimi i listës me softuerëve të aplikueshëm Sigurimi i të dhënave përmes sistemeve jashtë IGJK-së Krijimi i aplikacioneve të reja sipas nevojës Mirëmbajtja e web dhe aplikacioneve tjera Avancimi i bazës së të dhënave	Janar Dhjetor	
	Plotësimi dhe ndryshimi i regjistrit të aseteve	DAF	Regjistrimi i aseteve të reja Inventarizimi Vlerësimi Komisionet Azurnimi i regjistrit	Janar Dhjetor	Regjistri i plotësuar dhe ndryshuar
	Ndërtesa e IGJK-së	IGJK	Kërkesa për projekt dhe ndërtim të objektit drejtuar institucioneve vendore dhe donatorëve	Janar Dhjetor	Kërkesa e hartuar Projekti i përgatitur
	Krijimi i sistemit fizik dhe elektronik të arkivit	DAF	Sigurimi i kushteve për arkiva Krijimi i bazës së të dhënave Organizimi i arkivit Regjistrimi në bazën e të dhënave	Janar Dhjetor	Raportet nga baza e të dhënave
	Avancimi i shërbimeve të logjistikes	DAF	Identifikimi i nevojave dhe blerja e pajisjeve sipas nevojës Mirëmbajtja e pasurive dhe objektit Sigurimi i kushteve teknike sipas nevojës me furnizime dhe transport Regjistrimi në bazën e të dhënave dhe E-pasuri	Janar Dhjetor	Raportet e gjenerura nga baza e të dhënave

6 SFIDAT DHE RREZIQET

Realizimi i këtij programi përmban në vete edhe sfida të shumta, ndër të cilat theksojmë:

- **Reforma për edukimin ligjor** - Reforma për edukimin ligjor dhe transformimi i IGJK-së në Akademi të Drejtësisë me përgjegjësi të reja shtesë, si dhe koha se kur do të filloj zbatimi i tyre ndikon drejtpërdrejtë në funksionimin normal të IGJK-së dhe planifikimin e aktiviteteve në afat më të gjatë kohor.
- **Zgjedhja e Drejtorit** - IGJK aktualisht udhëhiqet nga U.D. i Drejtorit. IGJK gjatë vitit 2016 ka tentuar plotësimin e pozitës së drejtorit, mirëpo kjo çështje nuk është zgjedhur ende dhe mbetet sfidë për vitin 2017.
- **Mungesa e objektit të IGJK-së** – IGJK që nga viti 2006 veprimtarinë e tij e ushtron në një objekt privat me qira që njëkohësisht nuk i plotëson të gjitha kapacitetet me salla trajnimi si dhe hapësira me zyrë për stafin e IGJK-së.
- **Buxheti** – Sigurimi i buxhetit sipas planifikimeve të përcaktuara në programet trajnuese paraqet sfidë për IGJK-në për faktin e specifikave të këtij institucioni.
- **Personeli** – për të realizuar funksionet e tij profesionale IGJK-së i duhet personel i kualifikuar dhe profesional i motivuar, gjë të cilën vlerësojmë se është përmbushur në masën më të madhe. Megjithatë sfida e personelit paraqitet në dy drejtime; **i pari**, në mungesën e motivimit financiar, (brenda 6 viteve janë larguar 5 zyrtarët më të lartë profesional dhe drejtues), e cila vë në rrezik përmbushjen e objektivave, dhe **i dyti**, nevoja për ngritjen e kapaciteteve profesionale në aspektin praktik për të zbatuar standardet bashkëkohore dhe praktikat e zhvilluara të vendeve të Evropës në fushën e trajnimit gjyqësor.
- **Bashkëpunimi** – për të ushtruar funksionet e veta IGJK mbështetet shumë në bashkëpunimin ndërinstytucional me institucionet përgjegjëse të sistemit të drejtësisë në vendin tonë. Ky bashkëpunim duhet të reflektohet në rezultatet pozitive të punës së IGJK, pasi që përfitues të trajnimeve janë gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistët tjerë në baza vullnetare dhe kjo krijon mundësinë që rezultatet e pritshme të mos arrihen.
- **Legjislacioni** – Legjislacioni që rregullon sistemin gjyqësor dhe atë prokurorial në kontekst të trajnimit për gjyqtarë dhe prokurorë dhe ligjit për IGJK-në nuk është i harmonizuar, për çka e bën sfidues realizimin me sukses të këtyre objektivave. Po ashtu zhvillimet legjislative nganjëherë vijnë me një shpejtësi të paparashikueshme, gjë e cila mund të ndryshoj planifikimin dhe dinamikën e programeve tona trajnuese.

Rreziqet për mosarritjen/mospërmbushjen e këtij programi mund të jenë të gjithanshme duke filluar nga:

- ndryshimet e shpejta në legjislacion,
- zhvillimet në procesin e transformimit të IGJK-së në Akademi të Drejtësisë,
- buxheti,
- pjesëmarrja jo adekuate në trajnime e gjyqtarëve dhe prokurorëve krahas fushave të caktuara,
- mungesa e rekomandimeve për trajnime nga institucionet kompetente,
- centralizimi i prokurimit dhe prokurimi elektronik.

Instituti Gjyqësor i Kosovës do të hartoj një regjistër të veçantë të rreziqeve ku do të parashihen të gjitha rreziqet e mundshme, shkalla e rrezikut, personat përgjegjës për adresimin e këtyre rreziqeve si dhe specifika tjera siç përcaktohet me të gjitha standardet relevante.

7 PËRFUNDIMI

Krijimi i sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm, dhe efikas është i një rëndësie të madhe. Paanshmëria, integriteti dhe një standard i lartë i gjykimit nga ana e gjykatave janë thelbësore për ruajtjen e sundimit të ligjit. Kjo kërkon një angazhim të madh në drejtim të ngritjes së shkathtësive profesionale, ndërdisiplinore dhe personale të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ky program i punës i cili përmabnë kornizën e programit të trajnimit është në funksion të përmbushjes së kritereve të përcaktuara për zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe ndërdisiplinore të gjyqtarëve e prokurorëve si dhe profesionistëve tjerë të identifikuar nga IGJK, drejt zhvillimit të sistemit gjyqësor e prokurorial sipas standardeve bashkëkohore.

Me këtë rast shprehim falënderimin tonë të veçantë për të gjithë ata që kanë kontribuar në hartimin e tij si dhe ata që do të përfshihen në zbatimin dhe mbështesin zbatimin e tij gjatë vitit 2017.



<https://igjk.rks-gov.net>
infokji@rks-gov.net
Rr. "Muharrem Fejza" - Prishtinë